

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: : **KOMUNA E GJAKOVËS**

Nr i Prokurimit **632-26-4696-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Mbikëqyrja e Projekteve**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"P.M.N."SH.P.K&NPN "UNIVERS-MI

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Agron Rrahmani, Lok.I, Nr.14, Prishtinë

(Adresa)

Prishtine

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

+383 44 238-511

(Numri Telefonit)

(Numri)

ZENUN TOLAJ

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

pmn.shpk2@gmail.com

(Adresa elektronike)

19.08.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: : Mbikëqyrja e Projekteve Njoftimi për kontratë është bërë me datën 19.06.2026 dhe hapja publike është bërë me datën 13.07.2026. Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me procesin e vlerësimit është publikuar me datë 31.07.2026 ndërsa edhe njoftimin për tenderusin e eliminuar na është dërguar me datën 31.07.2026. Kriteri për dhënie të kontratës ka qenë: Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Hapja eshte bere ne platformën eprokurimi

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Me datën **05.08.2026** kemi parashtruar **Kërkesë për Rishqyrtim** kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës, të publikuar me datën **31.07.2026**, për aktivitetin e prokurimit **“Mbikëqyrja e Projekteve”**, me nr. të prokurimit **632-26-4696-2-1-1**.

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar kërkesën tonë për rishqyrtim dhe me datën **10.08.2026** ka nxjerrë Vendimin, përmes të cilit ka **refuzuar si të pabazuara pretendimet tona**, ka lënë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës **31.07.2026** dhe ka vendosur që aktiviteti i prokurimit të vazhdojë.

Duke mos u pajtuar me konstatimet dhe arsyetimin e Autoritetit Kontraktues të paraqitura në Vendimin e datës **10.08.2026**, dhe duke konsideruar se pretendimet tona nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtë, të plotë dhe në përputhje me kërkesat e LPP-së dhe legjislacionit sekondar të prokurimit publik, **në përputhje me LPP-në dhe brenda afatit ligjor, i drejtohem Organit Shqyrtues të Prokurimit – OSHP me këtë ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 10.08.2026**, duke kërkuar shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar dhe të pretendimeve tona ankimore.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjate vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka zbatuar me përpikëri të gjitha dispozitat e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Përpos kësaj AK nuk ka respektuar as kërkesat e dosjes së tenderit të cilat vetë i ka parashtruar në fillim të këtij procesi të prokurimit. Dispozitat që ne mendojmë se AK i ka shkelur janë:

Dispozitat e LPP-së

- **Neni 1 i LPP-së**
- **Neni 7 i LPP-së**
- **Neni 10 i LPP-së**
- **Neni 11 i LPP-së**
- **Neni 59 i LPP-së**
 - **Neni 59.4 i LPP-së**
- **Neni 69 i LPP-së**
- **Neni 72 i LPP-së**
- **Dispozita e Rregullores**
- **Nenin 7.6.2 dhe 7.6.3 të Rregullores Nr. 002/2024**
 - **Neni 38 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Më **31.07.2026**, Autoriteti Kontraktues ka publikuar njoftimin mbi vendimin, sipas të cilit për tenderues të suksesshëm është rekomanduar OE **“AL-Engineering” SH.P.K.**, me vlerë të ofertës **115,500.00 euro**, ndërsa GOE **“P.M.N.” SH.P.K. & NPN “UNIVERS-MI”** është njoftuar për eliminimin nga aktiviteti i prokurimit.

Në të njëjtën datë, më **31.07.2026**, **“P.M.N.” SH.P.K.** ka paraqitur kërkesë me shkrim për qasje në dokumentet zyrtare të aktivitetit **“Mbikëqyrja e Projekteve”**, me nr. të prokurimit **632-26-4696-2-1-1**.

Me emailin e datës **03.08.2026**, AK e ka njoftuar kërkesin se mund të paraqitet gjatë orarit të punës për qasje në dokumentacionin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Megjithatë, gjatë qasjes së datës **03.08.2026**, Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar dokumentacionin e saktë dhe të plotë të tenderuesit të rekomanduar për kontratë. Nga verifikimi i dokumenteve të vëna në dispozicion është konstatuar se ato i përkisnin operatorit ekonomik **N.N.P. “VETONI”** dhe lidheshin me një projekt tjetër.

Se ky operator ekonomik nuk ka qenë pjesëmarrës në aktivitetin përkatës të prokurimit vërtetohet drejtpërdrejt nga **Procesverbali i hapjes së tenderëve**. Sipas tabelës së tenderuesve në faqen 1 të procesverbalit, në këtë aktivitet kanë marrë pjesë vetëm:

- **FST Engineering SH.P.K.;**
- **Grupi i Operatorëve Ekonomikë P.M.N. SH.P.K. dhe UNIVERS-MI;**
- **AL-Engineering SH.P.K., MUH Engineering L.L.C. dhe HII NR.14 – PRISHTINË.**

Në këtë listë zyrtare të operatorëve që kanë dorëzuar oferta nuk figuron **N.N.P. “VETONI”**. Rrjedhimisht, dokumentet e këtij operatori nuk mund të konsiderohen pjesë e ofertës së tenderuesit të rekomanduar për kontratë, pasi ai nuk ka dorëzuar ofertë dhe nuk ka qenë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Për këtë parregullsi, më **04.08.2026**, GOE e ka njoftuar me email Autoritetin Kontraktues se dokumentacioni i ofruar gjatë qasjes nuk ishte dokumentacioni i operatorit ekonomik të shpallur fitues. Në të njëjtin email është kërkuar që Autoriteti Kontraktues ta sqarojë urgjentisht gabimin dhe që dokumentacionin e saktë e të plotë të operatorit të shpallur fitues ta dërgojë menjëherë përmes emailit. Bashkë me njoftimin janë identifikuar dhe bashkëngjitur dokumentet e dorëzuara gabimisht, përfshirë certifikatën e biznesit, deklaratën nën betim, certifikatat ISO, listën e punëtorëve dhe paramasën e N.N.P. “VETONI”.

Pavarësisht këtij njoftimi dhe kërkesës së qartë për mundësimin e qasjes, deri në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues:

- nuk e ka dërguar dokumentacionin e operatorit ekonomik të shpallur fitues;
- nuk ka njoftuar GOE-në se kur dhe në çfarë mënyre mund të realizohet qasja në këtë dokumentacion;
- nuk ka dhënë asnjë sqarim lidhur me dokumentacionin e gabuar të vënë në dispozicion.

Parregullsitë e konstatuara gjatë qasjes dhe lidhur me eliminimin tonë

Gjatë realizimit të qasjes në dokumentet zyrtare të këtij aktiviteti të prokurimit, kemi konstatuar një varg parregullsish dhe mosveprimesh nga ana e Autoritetit Kontraktues, si në raport me dokumentacionin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, ashtu edhe në raport me arsyet dhe bazën mbi të cilën është bërë eliminimi ynë.

Në veçanti, Autoriteti Kontraktues nuk na ka mundësuar qasje të plotë, të saktë dhe efektive në dokumentacionin relevant, duke na ofruar dokumente që nuk i përkisnin operatorit ekonomik të shpallur fitues. Po ashtu, deri në paraqitjen e kësaj kërkesë për rishqyrtim, nuk na është ofruar dokumentacioni i saktë dhe as nuk jemi njoftuar për mënyrën se si mund t’i qasemi atij.

Kjo mungesë e qasjes ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në mundësinë tonë për të verifikuar ligjshmërinë e eliminimit tonë, për të krahasuar trajtimin e ofertës sonë me atë të operatorit të rekomanduar për kontratë dhe për të konstatuar nëse kriteret janë zbatuar në mënyrë të barabartë dhe konsistente ndaj të gjithë tenderuesve.

Për këtë arsye, parregullsitë e konstatuara gjatë qasjes në dokumente zyrtare, si dhe shkeljet që lidhen me eliminimin tonë, do të paraqiten dhe arsyetohen në vijim.

Pretendimi nr 1

Shkelja e Nenit 10 të LPP-së – Pamundësimi i qasjes në dokumentacionin e operatorit ekonomik të shpallur fitues

Autoriteti Kontraktues ka cenuar të drejtën e GOE-së për qasje në dokumentacionin zyrtar të aktivitetit të prokurimit, duke vepruar në kundërshtim me parimin e transparencës dhe me dispozitat e legjislacionit të prokurimit publik.

Më **31.07.2026**, GOE ka paraqitur kërkesë për qasje në dokumentet zyrtare të aktivitetit të prokurimit me titull **“Mbikëqyrja e Projekteve”**, me numër prokurimi **632-26-4696-2-1-1**.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Autoriteti Kontraktues, më **03.08.2026 në ora 09:43**, e ka njoftuar GOE-në se mund të paraqitej po atë ditë, gjatë orarit të punës, për realizimin e qasjes.

Megjithatë, gjatë qasjes së realizuar më **03.08.2026**, në vend të dokumentacionit të operatorit ekonomik të shpallur fitues, Autoriteti Kontraktues ka vënë në dispozicion dokumentacion që i përkiste **N.N.P. “VETONI”** dhe që lidhej me një projekt tjetër. Ky operator nuk ka qenë pjesëmarrës në aktivitetin përkatës të prokurimit, siç vërtetohet edhe nga Procesverbali i hapjes së tenderëve.

Pas verifikimit të dokumenteve të marra, GOE, më **04.08.2026 në ora 10:31**, e ka njoftuar Autoritetin Kontraktues se dokumentacioni i dorëzuar ishte i pasaktë dhe se i përkiste një operatori jopjesëmarrës dhe një projekt tjetër. Në të njëjtin email është kërkuar sqarim urgjent dhe është kërkuar që dokumentacioni i saktë dhe i plotë i operatorit ekonomik të shpallur fitues të dërgohej menjëherë përmes emailit, me qëllim që GOE të mund ta analizonte dhe ta përgatiste kërkesën për rishqyrtim brenda afatit ligjor.

Autoriteti Kontraktues ka reaguar vetëm më **05.08.2026 në ora 09:44**, pra në ditën e fundit të afatit për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim, duke pranuar se kishte ndodhur gabim gjatë shkarkimit të dokumenteve dhe duke e ftuar GOE-në për riqasje fizike gjatë orarit të punës.

GOE i është përgjigjur më **05.08.2026 në ora 10:18**, duke kërkuar që dokumentacioni i operatorit ekonomik të shpallur fitues t’i dërgohej urgjentisht përmes emailit, pasi nuk kishte më kohë të mjaftueshme për marrjen fizike, shqyrtimin dhe analizimin e detajuar të tij, ndërkohë që po atë ditë skadonte afati për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim.

Pavarësisht këtyre kërkesave, deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues:

- nuk e ka dërguar dokumentacionin e operatorit ekonomik të shpallur fitues;
- nuk ka ofruar qasje të menjëhershme në versionin e pastruar të dokumentacionit;
- nuk ka mbajtur procesverbal për qasjen në dokumentacionin e saktë;
- ka ofruar qasje me vonesë, në një mënyrë që nuk mundësonte analizimin efektiv të dokumenteve brenda afatit ligjor;
- ka vënë fillimisht në dispozicion dokumente të një operatori që nuk ka qenë pjesëmarrës në procedurë.

Me këto veprime dhe mosveprime, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me **Nenin 10 të LPP-së**, si dhe me **Nenin 7.6.2 dhe 7.6.3 të Rregullores Nr. 001/2022, të ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024**, të cilat obligojnë përgatitjen e versionit të pastruar të dokumentacionit dhe ofrimin e qasjes së menjëhershme sipas kërkesës së operatorit ekonomik.

Rrjedhimisht, GOE-së nuk i është mundësuar qasje reale, e plotë dhe efektive në dokumentacionin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, duke i pamundësuar verifikimin e ligjshmërisë së ofertës së tij dhe përgatitjen e plotë të kërkesës për rishqyrtim brenda afatit ligjor.

Pretendimi nr 2

Shkelja e Nenit 1 të Ligjit për Prokurimin Publik – Cenimi i economicitetit dhe dëmi potencial ndaj buxhetit publik

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me **Nenin 1 të Ligjit për Prokurimin Publik**, i cili synon të sigurojë përdorimin më efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike, si dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit në mënyrë që të mbrohet interesi publik dhe të garantohet konkurrencë e ndershme ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Në rastin konkret, sipas Procesverbalit të hapjes së tenderëve, oferta e GOE **P.M.N. SH.P.K. & UNIVERS-MI** ka qenë në vlerë prej **75,762.71 €**, ndërsa oferta e GOE të shpallur fitues, **AL-Engineering SH.P.K., MUH Engineering L.L.C. & HII NR.14 – Prishtinë**, ka qenë në vlerë prej **97,881.36 €**.

Diferenca ndërmjet këtyre dy ofertave është:

$$97,881.36 € - 75,762.71 € = 22,118.65 €$$

Rrjedhimisht, oferta e operatorit të rekomanduar për kontratë është **22,118.65 € më e lartë** se oferta jonë, përkatësisht rreth **29.19% më e shtrenjtë**.

Nëse eliminimi i ofertës sonë rezulton të jetë bërë pa bazë ligjore dhe oferta jonë ka qenë e përgjegjshme, atëherë vendimi i Autoritetit Kontraktues për rekomandimin e një oferte më të lartë e ekspozon buxhetin publik ndaj një **shpenzimi shtesë dhe dëmi potencial në vlerë prej 22,118.65 €**.

Për rrjedhojë, eliminimi i ofertës sonë dhe rekomandimi për kontratë i një operatori me çmim dukshëm më të lartë cenon qëllimin e Nenit 1 të LPP-së, veçanërisht parimin e përdorimit ekonomik dhe efikas të fondeve publike. Autoriteti Kontraktues, në vend që të siguronte përfitimin më të mirë ekonomik për parane publike, ka rekomanduar një ofertë që e ngarkon buxhetin e shtetit me **22,118.65 € më shumë**.

Prandaj, kërkohet që të rishqyrtohet ligjshmëria e eliminimit tonë dhe e rekomandimit për dhënie të kontratës, pasi, në rast të konstatimit se oferta jonë është eliminuar në mënyrë të kundërligjshme, vendimi i AK-së përbën cenim të Nenit 1 të LPP-së dhe i shkakton ose rrezikon t'i shkaktojë buxhetit publik një dëm financiar prej **22,118.65 €**.

Pretendimi nr. 3

– Arkitekti Driton Kabashi

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues në Dosjen e Tenderit

Në pikën c) të kërkesave për personelin profesional, AK ka kërkuar:

Një Arkitekt të diplomuar ose Master të Arkitekturës, të licencuar me Licencë A nga OARK, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

Në sqarimet e DT-së është përcaktuar se përvoja profesionale duhet t'u përgjigjet **projekteve të ngjashme**, ndërsa kualifikimi shkollor duhet të jetë diplomë universitare me së paku 300 ECTS, sipas sistemit pesëvjeçar ose nivelit Master.

Dëshmitë e kërkuara në DT

AK ka kërkuar që kualifikimet shkollore dhe profesionale të stafit të dëshmohen me:

- CV;
- diplomë;
- kontratë pune ose kontratë mbi vepër, në të cilën specifikohet titulli i projektit;
- listën e stafit të angazhuar me emrin, mbiemrin, profesionin dhe pozitën në kompani.

AK nuk ka kërkuar referenca profesionale si dëshmi të detyrueshme për përvojën e arkitektit.

Për këtë arsye, vlerësimi i përvojës së z. Driton Kabashi duhet të bëhet në bazë të dokumenteve të përcaktuara shprehimisht në DT, e jo duke vendosur gjatë vlerësimit kërkesa shtesë lidhur me përmbajtjen ose periudhat e referencave.

Dokumentet e dorëzuara për z. Driton Kabashi

Për z. Driton Kabashi janë dorëzuar:

- diploma Master në Arkitekturë, me 303 ECTS, e përfunduar më 28.06.2018;
- Licenca A nr. A-0192;
- CV-ja profesionale;
- kontrata mbi vepër e datës 03.07.2026 për projektin “Mbikëqyrja e Projekteve”;
- lista e stafit profesional;
- si dokumente shtesë, edhe disa referenca profesionale.

Kontrata mbi vepër e specifikon titullin e projektit, numrin e prokurimit dhe detyrat e z. Kabashi në projektim, mbikëqyrje ose menaxhim, prandaj është në përputhje me kërkesën e DT-së për angazhimin e stafit për projektin konkret.

Përvoja profesionale e paraqitur në CV

Në pjesën “Punësimi” të CV-së është deklaruar shprehimisht se z. Driton Kabashi ka punuar në NN “Kabashi”:

“që nga viti 2015 e gjer më tani”,

duke kryer punë të projektimit, përgatitjes së dokumentacionit për tenderim, organizimit të personelit dhe mbikëqyrjes së punës.

CV-ja paraqet gjithashtu se nga prilli 2023 z. Kabashi ushtron pozitën e Drejtorit Menaxhues dhe Arkitektit në “Kabashi-Projektim&Ndërtim” SH.P.K. Në CV janë paraqitur edhe angazhime profesionale në projektim dhe mbikëqyrje me Mercom Company, Euro Stil dhe Real Invest.

Z. Kabashi ka diplomuar më **28.06.2018**, ndërsa afati i dorëzimit dhe hapjes së ofertave ka qenë më **13.07.2026**. Nga data e diplomimit deri në datën e ofertimit kanë kaluar:

8 vite e 15 ditë.

Meqenëse CV-ja e dorëzuar paraqet angazhimin profesional “nga viti 2015 e gjer më tani”, ajo dëshmon se angazhimi ka vazhduar edhe pas diplomimit dhe se periudha pas 28.06.2018 tejkalon minimumin prej 5 viteve të kërkuar në DT.

Prandaj, konstatimi i AK-së se CV-ja nuk përmban periudhën e përvojës nuk është i saktë. CV-ja përmban periudhën e angazhimit kryesor dhe vazhdimësinë e tij deri në kohën e ofertimit.

Përdorimi i referencave si bazë eliminimi

Në letrën e eliminimit, AK ka konstatuar se viti 2015 i paraqitur në CV nuk përputhet me datën 01.02.2017 në referencën e NN “Kabashi” dhe se “edhe nga referencat e prezantuara” nuk dëshmohet përvoja 5-vjeçare pas diplomimit.

Ky arsyetim nuk është në përputhje me kërkesat e DT-së, sepse **referencat nuk janë kërkuar si dëshmi të detyrueshme.**

Referencat janë dorëzuar si dokumente shitesë dhe mund të përdoren vetëm për të konkretizuar natyrën e punëve të kryera, por jo të shndërrohen në kriter të ri eliminues. AK nuk mund të kërkojë që referencat të përmbajnë data të sakta të fillimit dhe përfundimit, kur një kërkesë e tillë nuk është përcaktuar në DT.

Edhe dallimi ndërmjet vitit 2015 në CV dhe datës 01.02.2017 në referencë nuk e rrëzon përvojën pas diplomimit. Të dyja datat janë para 28.06.2018, ndërsa dokumenti i kërkuar nga AK, përkatësisht CV-ja, paraqet vazhdimësinë e angazhimit “gjer më tani”.

Projektet e ngjashme dhe jo projektet e njëjta

AK ka kërkuar përvojë që u përgjigjet **projekteve të ngjashme**, dhe jo projekteve të njëjta ose me titull identik me objektin e prokurimit.

Projekte të njëjta do të nënkuptonin projekte me titull, objekt dhe detyra identike. Ndërsa projekte të ngjashme përfshijnë projekte me natyrë, përgjegjësi dhe funksione profesionale të krahasueshme.

Përvoja e z. Kabashi në:

- projektim arkitektonik;
- mbikëqyrje të objekteve;
- organizim dhe menaxhim të punimeve;
- menaxhim të punishtes;
- përgatitje të dokumentacionit teknik;
- trajtim të problemeve gjatë projektimit dhe mbikëqyrjes,

është e ngjashme dhe profesionalisht e krahasueshme me objektin “Mbikëqyrja e Projekteve”.

Referencat e dorëzuara, ndonëse nuk kanë qenë të detyrueshme, konfirmojnë natyrën e këtyre angazhimeve në projektim, mbikëqyrje dhe menaxhim.

Prandaj, AK nuk mund ta ngushtojë termin “projekte të ngjashme” në kërkesë për projekte të njëjta ose vetëm për projekte që mbajnë titullin “Mbikëqyrja e Projekteve”.

Paqartësia eventuale duhej të sqarohej

Nëse AK ka konsideruar se shprehja “nga viti 2015 e gjer më tani” nuk ishte mjaftueshëm e saktë për shkak të mungesës së muajit ose datës së plotë, kjo përbënte një **paqartësi të sqarueshme në CV**, dhe jo mungesë të përvojës profesionale.

Sqarimi do të shërbente vetëm për konfirmimin e datës së fillimit dhe vazhdimësisë së një angazhimi që, sipas CV-së, ka ekzistuar para dorëzimit të tenderit. Ai nuk do të krijonte përvojë të re dhe as nuk do ta ndryshonte përmbajtjen materiale të ofertës.

Për këtë arsye, AK duhej të kërkonte sqarimin e të dhënave të paraqitura në CV, në pajtim me nenin 72 të LPP-së dhe nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022, në vend që ta eliminonte ofertën duke u mbështetur në përmbajtjen e referencave që nuk ishin kërkuar në DT.

Shkeljet e Autoritetit Kontraktues

Me eliminimin e ofertës lidhur me z. Driton Kabashi, konsiderojmë se AK ka vepruar në kundërshtim me:

- **Nenin 59 të LPP-së**, sepse nuk e ka ekzaminuar dhe vlerësuar dokumentacionin në tërësi dhe sipas dëshmive të përcaktuara në DT;
- **Nenin 69 të LPP-së**, sepse aftësia teknike dhe profesionale nuk është vlerësuar sipas kërkesës dhe mënyrës së dëshmimit të publikuar në DT;
- **Nenin 72 të LPP-së**, sepse paqartësia eventuale lidhur me saktësinë e periudhës së deklaruar në CV mund të sqarohej pa ndryshuar ofertën;

- **Nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022**, lidhur me sqarimin e dokumenteve të aftësisë teknike dhe profesionale;
- **Nenin 7 të LPP-së**, sepse AK nuk mund të vendosë gjatë vlerësimit kërkesa të reja për referenca dhe as ta shndërrojë termin “projekte të ngjashme” në kërkesë për projekte të njëjta.

Kërkojmë që **Pretendimi nr. 1 të aprovohet si i bazuar** dhe të anulohet arsyeja e eliminimit lidhur me z. Driton Kabashi.

Pretendimi nr. 4

– Inxhinieri i Elektrikës Lulzim Halitaj

Kërkesa e AK-së në Dosjen e Tenderit

Në pikën d) të kërkesave për personelin profesional, AK ka kërkuar:

Një Inxhinier të Diplomuar ose Master në Inxhinieri Elektrike, me Licencë A nga OIRK dhe me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

Në sqarimet e DT-së është përcaktuar se përvoja profesionale duhet t’u përgjigjet **projekteve të ngjashme**, ndërsa diploma duhet të jetë universitare me së paku 300 ECTS, sipas sistemit pesëvjeçar ose nivelit Master.

Dëshmitë e kërkuara në DT

AK ka kërkuar që kualifikimet shkollore dhe profesionale të stafit të dëshmohen me:

- CV;
- diplomë;
- kontratë pune ose kontratë mbi vepër, ku specifikohet titulli i projektit;
- listën e stafit të angazhuar me emrin, mbiemrin, profesionin dhe pozitën në kompani.

AK nuk ka kërkuar referenca profesionale si dëshmi të detyrueshme për përvojën e inxhinierit elektrik.

Prandaj, përmbajtja ose ndonjë gabim material në referencat e dorëzuara si dokumente shtesë nuk mund të shndërrohet në kriter eliminues që nuk ka qenë i paraparë në DT.

Dokumentet e dorëzuara

Për z. Lulzim Halitaj janë dorëzuar:

- diploma Master në Inxhinieri Elektrike, drejtimi Elektroenergjetikë, me datë përfundimi 04.05.2018;
- Licenca A nr. E-0042, e vlefshme deri më 14.11.2029;
- CV-ja profesionale;

- kontrata mbi vepër për projektin “Mbikëqyrja e Projekteve”;
- lista e stafit profesional;
- lista e projekteve të menaxhuara;
- si dokumente shitesë, referenca profesionale.

Kontrata mbi vepër e datës 09.07.2026 specifikon titullin “Mbikëqyrja e Projekteve”, numrin e prokurimit dhe detyrat në projektim, mbikëqyrje ose menaxhim, duke e plotësuar kërkesën e DT-së për angazhimin në projektin konkret.

Përvoja profesionale e paraqitur në CV

CV-ja paraqet qartë këto angazhime:

- **EUROING: 2018–2026 dhe vazhdon**, në pozitën Inxhinier Elektrik – Auditor i Energjisë;
- **Syla Group: 2018–2022 dhe 2025–vazhdon**;
- **Valmet AB: 04.2014–12.2023**;
- **Links 4: 03.2016–03.2018**;
- **U Architects: 01.2014–03.2016**.

Për angazhimin në EUROING, CV-ja përshkruan projektimin e instalimeve elektrike, përgatitjen e skemave dhe diagrameve, zbatimin e standardeve profesionale dhe integrimin e projekteve elektrike në projekte më të mëdha.

Për angazhimin në Links 4, CV-ja përfshin monitorimin e zbatimit të projekteve elektrike, kontrollin e përputhshmërisë me specifikimet, standardet e cilësisë dhe afatet, si dhe menaxhimin dhe mbikëqyrjen e ekipeve dhe burimeve. Për U Architects përmendet gjithashtu monitorimi i projekteve në cilësinë e mbikëqyrësit.

Z. Halitaj ka diplomuar më **04.05.2018**, ndërsa hapja e ofertave është bërë më **13.07.2026**. Nga diplomimi deri në hapjen e ofertave kanë kaluar:

8 vite, 2 muaj dhe 9 ditë.

CV-ja deklaron angazhim në EUROING nga viti 2018 deri në vitin 2026 dhe vazhdon. Rrjedhimisht, dokumenti që AK vetë e ka kërkuar paraqet një periudhë profesionale pas diplomimit që tejkalon minimumin prej 5 viteve.

Arsyeja e eliminimit

AK ka konstatuar se z. Halitaj nuk e dëshmon përvojën pesëvjeçare pas diplomimit në fushën e ngjashme dhe është mbështetur edhe në:

- pretendimin se referenca e EUROING-ut nuk përputhet me CV-në;
- faktin se në referencën e EUROING-ut është shënuar gabimisht emri “Emine Gllareva”;
- konstatimin se referenca e Syla Group dëshmon projektim dhe jo mbikëqyrje.

Ky arsyetim është i pabazuar, sepse referencat nuk kanë qenë dokumente të detyrueshme sipas DT-së. Përvoja është kërkuar të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontratë pune ose kontratë mbi vepër.

Lista e projekteve të menaxhuara

Në dokumentacion është dorëzuar edhe “Lista e Projekteve të Menaxhuara 2018–2025”, e cila përmban projekte të realizuara në kuadër të EUROING-ut, Syla Group, UA Architects, Consult-Eng, G-Project dhe Studio Links 4.

Lista përfshin projektim, menaxhim, auditim energjetik, monitorim dhe realizim të projekteve elektrike e ndërtimore gjatë viteve 2018–2025.

Kjo listë, e vlerësuar së bashku me CV-në, e konkretizon natyrën profesionale të përvojës dhe tregon angazhime pas diplomimit për një periudhë më të gjatë se pesë vite.

Projekte të ngjashme, jo projekte të njëjta

DT-ja ka kërkuar përvojë në **projekte të ngjashme**, jo vetëm në projekte me titull identik “Mbikëqyrja e Projekteve”.

Projekt i njëjtë do të kërkonte objekt dhe detyra identike. Ndërsa projektet e ngjashme përfshijnë angazhime me natyrë dhe përgjegjësi profesionale të krahasueshme.

Përvoja e z. Halitaj përfshin:

- projektimin e instalimeve elektrike;
- monitorimin e zbatimit të projekteve;
- kontrollin e përputhshmërisë me projektin, standardet dhe afatet;
- menaxhimin dhe udhëheqjen e projekteve;
- mbikëqyrjen e ekipeve dhe burimeve;
- auditimin energjetik;
- hartimin e raporteve dhe specifikimeve teknike.

Këto detyra janë profesionalisht të ngjashme me mbikëqyrjen e projekteve. AK nuk mund ta ngushtojë termin “projekte të ngjashme” në pesë vite përvojë vetëm në projekte që mbajnë titullin formal “mbikëqyrje”.

Fakti që referenca e Syla Group përdor termin “projektues” nuk e bën përvojën të parëndësishme, sepse DT nuk ka kërkuar projekte identike dhe as nuk ka kërkuar që çdo angazhim profesional të quhet formalisht “mbikëqyrje”.

Paqartësia eventuale duhej të sqarohet

Nëse AK kishte paqartësi lidhur me:

- natyrën e detyrave të paraqitura në CV;
- raportin ndërmjet CV-së dhe referencës së EUROING-ut;

- gabimin material në emër;
- periudhën e angazhimit profesional,

duhej të kërkonte sqarimin e dokumenteve ekzistuese dhe jo ta eliminonte ofertën.

Sqarimi nuk do të krijonte përvojë të re pas dorëzimit të tenderit, por vetëm do të konfirmonte të dhënat dhe angazhimet që ekzistonin para afatit të ofertimit.

Shkeljet e AK-së

Me eliminimin e ofertës lidhur me z. Lulzim Halitaj, konsiderojmë se AK ka vepruar në kundërshtim me:

- **Nenin 59 të LPP-së**, sepse nuk e ka ekzaminuar dhe vlerësuar dokumentacionin në tërësi;
- **Nenin 69 të LPP-së**, sepse aftësia teknike dhe profesionale nuk është vlerësuar sipas kërkesave dhe dëshmive të përcaktuara në DT;
- **Nenin 72 të LPP-së**, sepse paqartësitë dhe gabimi material kanë mundur të sqarohen pa ndryshuar përmbajtjen materiale të ofertës;
- **Nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022**, sepse AK ka mundur të kërkojë sqarimin e dokumenteve të aftësisë teknike dhe profesionale;
- **Nenin 7 të LPP-së**, sepse AK ka zbatuar një interpretim më kufizues se formulimi i publikuar, duke i trajtuar “projektet e ngjashme” sikur të kërkoreshin projekte të njëjta.

Kërkojmë që **Pretendimi nr. 2 të aprovohet si i bazuar** dhe të anulohet arsyeja e eliminimit lidhur me z. Lulzim Halitaj.

Pretendimi nr. 5

– **Inxhinieri i Gjeodezisë, z. Luan Abazi**

Kërkesa e AK-së në Dosjen e Tenderit

Në pikën ë) të kërkesave për personelin profesional, AK ka kërkuar:

Një Bachelor të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës, drejtimi Gjeodezi, të licencuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Në këtë pikë të DT-së, ndryshe nga kërkesat për disa pozita të tjera të stafit, **nuk është përcaktuar shprehimisht minimumi prej 5 viteve përvojë pas diplomimit.**

Në pjesën e sqarimeve është përcaktuar në mënyrë të përgjithshme se përvoja profesionale nënkupton përvojë që u përgjigjet projekteve të ngjashme, 5 vite pas diplomimit. Edhe nëse ky sqarim konsiderohet i zbatueshëm për pozitën e gjeodetit, z. Luan Abazi e tejkalon dukshëm këtë periudhë.

Dëshmitë e kërkuara në DT

AK ka kërkuar që kualifikimet shkollore dhe profesionale të stafit të dëshmohen me:

- CV;
- diplomë;
- kontratë pune ose kontratë mbi vepër, ku specifikohet titulli i projektit;
- listën e stafit profesional me emër, mbiemër, profesion dhe pozitë në kompani.

AK nuk ka kërkuar referenca profesionale si dëshmi të detyrueshme.

Prandaj, vlerësimi duhej të bëhej mbi bazën e CV-së, diplomës, licencës dhe kontratës së angazhimit, ndërsa referencat e dorëzuara mund të shërbenin vetëm si dokumente plotësuese.

Dokumentet e dorëzuara për z. Luan Abazi

Për z. Luan Abazi janë dorëzuar:

- diploma Master Profesional në Inxhinieri Gjeodezi, e lëshuar më 18.02.2014;
- licenca nr. 129 për gjeodet të licencuar, e lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, e vlefshme deri më 20.10.2028;
- CV-ja profesionale;
- kontrata mbi vepër për projektin “Mbikëqyrja e Projekteve”;
- lista e stafit profesional;
- dokumente dhe referenca plotësuese për projekte gjeodezike dhe infrastrukturore.

Kontrata mbi vepër e datës 02.07.2026 specifikon projektin “Mbikëqyrja e Projekteve”, numrin e prokurimit dhe angazhimin e z. Abazi për projektin konkret, duke përmbyllur kërkesën e DT-së për kontratën mbi vepër.

Përvoja profesionale e paraqitur në CV

Në CV është deklaruar se z. Luan Abazi është i angazhuar:

“Janar 2013 – vazhdon”

si Ekspert i Gjeodezisë, Drejtor i N.SH. “Geo&Metri” dhe gjeodet i licencuar, me detyra në matje inxhinierike dhe kadastrale.

Në CV paraqiten gjithashtu:

- matje gjeodezike;
- piketim;
- mbikëqyrje profesionale;
- matje me GPS dhe TCR;
- hartim dhe revidim projektsh;
- projekte rrugore dhe infrastrukturore;

- projekti “Mbikëqyrja e projekteve investive Lot 1/Pjesa 1”.

Z. Abazi ka diplomuar më **18.02.2014**, ndërsa hapja e ofertave është bërë më **13.07.2026**. Nga diplomimi deri në hapjen e ofertave kanë kaluar:

12 vite, 4 muaj dhe 25 ditë.

Meqenëse CV-ja paraqet angazhimin profesional nga janari 2013 dhe vazhdon, rezulton se përvoja e tij pas diplomimit tejkalon dukshëm minimumin prej 5 viteve, edhe nëse ky kusht konsiderohet i zbatueshëm për pozitën ë).

Arsyeja e eliminimit

AK ka konstatuar se z. Luan Abazi nuk e dëshmon me CV dhe referenca minimumin prej 5 viteve përvojë pas diplomimit në fushën e ngjashme, përkatësisht në mbikëqyrje të projekteve.

Ky konstatim është i pabazuar për dy arsye kryesore:

Së pari, në pikën specifike ë) të DT-së nuk është kërkuar shprehimisht përvojë minimale pesëvjeçare. Kërkesa specifike është kufizuar në kualifikimin Bachelor në Gjeodezi dhe licencimin nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Së dyti, edhe nëse zbatohet sqarimi i përgjithshëm për pesë vite pas diplomimit, CV-ja paraqet angazhim nga janari 2013 dhe vazhdon, ndërsa nga diplomimi deri në hapjen e ofertave kanë kaluar mbi 12 vite.

Referencat nuk kanë qenë dëshmi e detyrueshme

AK është mbështetur në konstatimin se edhe referencat nuk dëshmojnë përvojën pesëvjeçare.

Megjithatë, DT-ja nuk ka kërkuar referenca si dëshmi të detyrueshme. Prandaj, AK nuk mund t'i shndërrojë referencat e dorëzuara si dokumente plotësuese në kriter të ri eliminues.

Në çdo rast, dokumentet plotësuese paraqesin projekte konkrete në:

- incizime gjeodezike;
- rrugë dhe infrastrukturë;
- kanalizim dhe ujësjellës;
- matje dhe piktet;
- menaxhim dhe mbikëqyrje profesionale;
- projekte investive dhe publike.

Këto dokumente e përforcojnë, dhe nuk e mohojnë, përvojën e paraqitur në CV.

Projekte të ngjashme, jo projekte të njëjta

DT-ja ka përdorur termin “**projekte të ngjashme**”, jo “projekte të njëjta”.

Një projekt i njëjtë do të kërkonte titull, objekt dhe detyra identike me aktivitetin e prokurimit. Projektet e ngjashme përfshijnë veprimtari me natyrë dhe përgjegjësi profesionale të krahasueshme.

Përvoja e z. Luan Abazi në:

- matje gjeodezike;
- piketim;
- incizime të terrenit;
- kontroll dhe mbikëqyrje profesionale;
- projekte rrugore;
- kanalizim dhe ujësjellës;
- menaxhim të projekteve gjeodezike,

është drejtpërdrejt e krahasueshme me detyrat e gjeodetit në kuadër të mbikëqyrjes së projekteve.

Për më tepër, në CV është paraqitur edhe projekti me titull “Mbikëqyrja e projekteve investive Lot 1/Pjesa 1”, i cili lidhet drejtpërdrejt me objektin e aktivitetit të prokurimit.

AK nuk mund ta kufizojë përvojën e ngjashme vetëm në projekte që mbajnë titull identik “Mbikëqyrja e Projekteve”.

Shkeljet e AK-së

Me eliminimin e ofertës lidhur me z. Luan Abazi, konsiderojmë se AK ka vepruar në kundërshtim me:

- **Nenin 59 të LPP-së**, sepse nuk e ka vlerësuar dokumentacionin në tërësi;
- **Nenin 69 të LPP-së**, sepse nuk e ka vlerësuar aftësinë teknike dhe profesionale sipas kërkesës specifike dhe dëshmive të përcaktuara në DT;
- **Nenin 72 të LPP-së**, sepse çdo paqartësi eventuale rreth natyrës ose vazhdimësisë së angazhimit mund të sqarohej pa ndryshuar përmbajtjen materiale të ofertës;
- **Nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022**, lidhur me sqarimin e dokumenteve të aftësisë teknike dhe profesionale;
- **Nenin 7 të LPP-së**, sepse AK ka aplikuar një interpretim më kufizues se formulimi i publikuar dhe ka trajtuar projektet e ngjashme sikur të kërkoreshin projekte të njëjta.

Kërkojmë që **Pretendimi nr. 3 të aprovohet si i bazuar** dhe të anulohet arsyeja e eliminimit lidhur me z. Luan Abazi.

Pretendimi nr. 6

– Inxhinieri i Gjeodezisë, z. Agron Shabani

Kërkesa e AK-së në Dosjen e Tenderit

Në pikën ë1) AK ka kërkuar:

Një Bachelor të Gjeodezisë.

Në këtë kërkesë specifike **nuk është përcaktuar shprehimisht minimumi prej 5 viteve përvojë pas diplomimit**. Në pjesën e përgjithshme të sqarimeve është përmendur përvoja në projekte të ngjashme, 5 vite pas diplomimit. Edhe nëse ky sqarim konsiderohet i zbatueshëm për pozitën ë1), z. Agron Shabani e plotëson dhe e tejkalon këtë kusht.

Dëshmitë e kërkuara nga AK

Kërkojmë nga OSHP që këtë pretendim ta aprovojë si të bazuar

PËRGJIGJE NDAJ ARSYETIMIT TË VENDIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTUES TË DATËS 10.08.2026

GOE “P.M.N.” SH.P.K. & N.P.N. “UNIVERS-MI” nuk pajtohet me arsyetimin e Autoritetit Kontraktues të paraqitur në Vendimin e datës 10.08.2026, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesa jonë për rishqyrtim e datës 05.08.2026.

Në vijim, secili pretendim i paraqitur në kërkesën për rishqyrtim trajtohet **veçmas**, duke paraqitur fillimisht arsyetimin që ka dhënë AK dhe pastaj kundërpërgjigjen tonë konkrete ndaj atij arsyetimi.

PRETENDIMI NR. 1

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues në Vendimin e datës 10.08.2026

Autoriteti Kontraktues e ka konsideruar të pabazuar pretendimin tonë lidhur me pamundësimin e qasjes në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

AK deklaron se njoftimi ynë lidhur me dokumentacionin e gabuar është pranuar më 04.08.2026 në ora 15:38 dhe jo në ora 10:31, siç është paraqitur në kërkesën tonë për rishqyrtim.

Më tej, AK deklaron se më 05.08.2026 në ora 09:44 na ka njoftuar se gjatë shkarkimit dhe bartjes së dokumenteve kishte ndodhur një gabim teknik dhe na ka ftuar të paraqitemi përsëri për marrjen e dokumentacionit të saktë.

Sipas AK-së, pasi GOE në ora 10:19 ka kërkuar që dokumentacioni t'i dërgohet përmes postës elektronike, AK ka filluar dërgimin e dokumenteve në ora 11:23, ndërsa e-maili i fundit është dërguar në ora 11:39. Meqenëse kërkesa jonë për rishqyrtim është pranuar në sistem në ora 11:46, AK konsideron se dokumentacioni na është vënë në dispozicion para paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim dhe para skadimit të afatit ligjor.

Kundërpërgjigja e GOE-së

GOE “P.M.N.” SH.P.K. & N.P.N. “UNIVERS-MI” nuk pajtohet me këtë arsyetim, sepse AK e redukton çështjen vetëm në momentin formal të dërgimit të disa e-maileve dhe nuk e trajton thelbin e pretendimit tonë: **a na është mundësuar apo jo qasje reale, e plotë, e rregullt dhe**

efektive në dokumentacion, në kohë të mjaftueshme që atë dokumentacion ta shqyrtojmë dhe ta përdorim për ushtrimin e mjetit juridik.

GOE ka kërkuar qasje në dokumentacion që më **31.07.2026**. Më 03.08.2026, gjatë realizimit të qasjes, në vend të dokumentacionit të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, AK na ka vënë në dispozicion dokumentacion të **N.N.P. “VETONI”**, i cili nuk ka qenë fare pjesëmarrës në aktivitetin konkret të prokurimit dhe dokumentacioni i të cilit lidhej me një projekt tjetër. Pas konstatimit të gabimit, AK është njoftuar dhe i është kërkuar urgjentisht dokumentacioni i saktë, ndërsa gabimin e ka pranuar vetëm më **05.08.2026**, në ditën e fundit të afatit për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim. Këto rrethana janë paraqitur qartë edhe në kërkesën tonë fillestare për rishqyrtim.

Për këtë arsye, nuk mund të konsiderohet se AK e ka përmbushur detyrimin ligjor vetëm për faktin se dokumentet janë dërguar teknikisht para regjistrimit të kërkesës për rishqyrtim.

Sipas vetë arsytimit të AK-së, e-maili i fundit është dërguar në ora **11:39**, ndërsa kërkesa jonë për rishqyrtim është regjistruar në ora **11:46**. Pra, ndërmjet dërgimit të fundit të dokumenteve dhe paraqitjes së kërkesës kanë kaluar vetëm **shtatë minuta**.

Objektivisht, brenda shtatë minutave nuk mund të pritet që një operator ekonomik të shkarkojë dokumentacionin, ta sistemojë, ta verifikojë, ta analizojë në raport me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe, më pas, të përgatisë pretendime juridike të argumentuara për kërkesën për rishqyrtim.

Në këtë rast duhet të merret parasysh edhe fakti se vonesa nuk është shkaktuar nga GOE, por nga vetë Autoriteti Kontraktues, i cili gjatë qasjes së parë ka dorëzuar dokumentacionin e gabuar. Për rrjedhojë, AK nuk mund ta përdorë afatin e mbetur formal të GOE-së si argument në favor të vet, kur pikërisht veprimi i gabuar i AK-së e ka konsumuar pjesën më të madhe të kohës në dispozicion.

Shkelja e Nenit 10 të LPP-së

Arsyetime i AK-së është në kundërshtim me **Nenin 10 të LPP-së – Mjetet për promovimin e Transparencës**.

Sipas Nenit 10.3, me kërkesë me shkrim të një pale të interesuar, AK duhet t'i sigurojë asaj **qasje të arsyeshme** në të dhënat e aktivitetit të prokurimit, me përjashtim të informatave të klasifikuara ligjërisht si sekrete afariste.

Në rastin konkret, GOE ka kërkuar qasje në dokumentacionin e operatorit të rekomanduar, ndërsa AK ka ofruar fillimisht dokumentacion të një operatori tjetër dhe të një procedure tjetër. Një qasje e tillë nuk mund të konsiderohet “qasje e arsyeshme” në dokumentacionin e aktivitetit përkatës të prokurimit.

Edhe më e qartë është dispozita e **Nenit 10.4**, sipas së cilës AK duhet ta sigurojë qasjen **në mënyrë të rregullt, të qetë dhe pa pengesa**.

Në rastin tonë, qasja nuk është realizuar në mënyrë të rregullt dhe pa pengesa: fillimisht është dhënë dokumentacioni i gabuar, gabimi është konstatuar dhe raportuar, është pranuar vetëm në

ditën e fundit të afatit dhe dokumentacioni është dërguar vetëm pak minuta para se GOE ta paraqiste kërkesën për rishqyrtim.

Po ashtu, sipas **Nenit 10.5 të LPP-së**, me kërkesë të palës së interesuar, AK duhet t'i sigurojë asaj kopje të materialit në të cilin ka të drejtë qasjeje.

Prandaj, detyrimi i AK-së nuk përfundonte me një dërgim formal të e-mailit, por kërkonte që dokumentacioni i saktë dhe i plotë t'i vihej GOE-së realisht në dispozicion.

Shkelja e Nenit 11.4 të LPP-së

Po ashtu, **Neni 11.4 i LPP-së** përcakton se, nëse një dokument përmban elemente të klasifikuara si sekret afarist, AK duhet të përgatisë **versionin e pastruar** të tij, në mënyrë që informacioni që nuk është sekret të mbetet në materialin në të cilin kanë qasje publiku dhe palët e interesuara.

Pra, edhe ekzistenca eventuale e informatave konfidenciale nuk e lironte AK-në nga detyrimi për të siguruar dokumentacionin. Përkundrazi, AK kishte detyrim pozitiv që ta përgatiste paraprakisht versionin e pastruar dhe ta bënte atë të qasshëm.

Shkelja e Nenit 7.4 të Rregullores Nr. 001/2022

Edhe Rregullorja Nr. 001/2022 është e qartë në këtë aspekt.

Sipas **Nenit 7.4**, përveç dokumenteve të klasifikuara si sekrete afariste, AK duhet t'i ofrojë çdo pale të interesuar që paraqet kërkesë **qasje të shpejtë dhe të arsyeshme në të gjitha të dhënat e aktivitetit të prokurimit**.

Në rastin konkret, nuk mund të flitet për qasje “të shpejtë dhe të arsyeshme”, kur:

- kërkesa është bërë më 31.07.2026;
- më 03.08.2026 është dhënë dokumentacion i një operatori tjetër;
- AK është njoftuar për gabimin;
- dokumentacioni i saktë nuk është vënë në dispozicion deri në ditën e fundit të afatit;
- dhe dërgimi është bërë vetëm pak minuta para paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim.

Shkelja e Nenit 7.6.2 dhe 7.6.3 të Rregullores Nr. 001/2022, të ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024

Në rastin konkret janë veçanërisht të rëndësishme edhe dispozitat e reja të Nenit 7.6.2 dhe 7.6.3.

Sipas **Nenit 7.6.2**, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet, **menjëherë pas procesit të hapjes së ofertave dhe para publikimit të B58 – “Njoftimi mbi Vendimin e AK-së”**, ta përgatisë versionin e pastruar të dokumentacionit në përputhje me Nenin 11.4 të LPP-së.

Kjo dispozitë e rrëzon edhe arsyetimin e AK-së se më 05.08.2026 ka pasur problem gjatë “shkarkimit dhe bartjes” së dokumenteve. Në momentin kur B58 është publikuar më 31.07.2026, versioni i pastruar i dokumentacionit **është dashur tashmë të ishte i përgatitur**.

Prandaj, GOE nuk është dashur të presë deri më 05.08.2026 që AK të korrigjojë dokumentacionin e gabuar.

Edhe më kategorik është **Neni 7.6.3**, sipas të cilit, pas publikimit të B58 dhe pas kërkesës së OE-së për qasje, Zyrtari i Prokurimit “**ofron qasjen e menjëhershme në versionin e pastruar dhe mban procesverbal, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.**”

Në rastin konkret, qasja nuk është ofruar “menjëherë”.

Përkundrazi, nga data 31.07.2026 deri më 05.08.2026 GOE nuk e ka pasur në dispozicion dokumentacionin e saktë dhe të përdorshëm të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Po ashtu, për dokumentacionin e saktë nuk rezulton të jetë mbajtur procesverbali i qasjes, i nënshkruar nga të dyja palët, siç kërkohet shprehimisht nga kjo dispozitë.

Paqartësitë në vetë provat e paraqitura nga AK

Për më tepër, edhe dokumentet që AK i ka bashkëngjitur vetë Vendimit krijojnë paqartësi serioze nëse është dërguar dokumentacioni i plotë i operatorit ekonomik të rekomanduar.

Nga provat e paraqitura shihen dërgesa me titull “**Dokumentet e kërkuara pjesa 1 – AI Engineering**”, më pas pjesa 3, pjesa 4 dhe pjesa 5.

Ndërsa dërgesat e mëvonshme, përfshirë ato deri në ora 11:39, lidhen me **FST ENGINEERING**.

Në veçanti, e-maili i orës 11:39, të cilin AK e përdor për të argumentuar se dokumentacioni ishte dërguar para paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim, nuk ka për subjekt dokumentacionin e AL-Engineering, por dokumentacion të FST Engineering.

Për këtë arsye, vetëm fakti se “e-maili i fundit” është dërguar në ora 11:39 nuk provon se në ora 11:39 ishte kompletuar dokumentacioni i operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Po ashtu, nga provat e paraqitura nga AK nuk identifikohet qartë **pjesa 2 e dokumentacionit të AL-Engineering**.

Kjo e bën edhe më të pabazuar konstatimin kategorik të AK-së se GOE e ka pasur dokumentacionin e plotë në dispozicion para paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim.

Përfundimi për Pretendimin nr. 1

Për rrjedhojë, nuk kemi të bëjmë thjesht me një “gabim teknik”, por me mosrespektimin e detyrimeve konkrete të Autoritetit Kontraktues në lidhje me transparencën dhe qasjen në dokumentacion.

Konsiderojmë se AK ka vepruar në kundërshtim me **Nenin 10.3, 10.4 dhe 10.5 të LPP-së**, me **Nenin 11.4 të LPP-së**, si dhe me **Nenin 7.4, 7.6.2 dhe 7.6.3 të Rregullores Nr. 001/2022, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024**.

Veçanërisht, AK nuk e ka respektuar detyrimin që versioni i pastruar të përgatitet para publikimit të B58 dhe që, pas kërkesës së operatorit ekonomik, të ofrohet **qasje e menjëhershme** në atë dokumentacion.

Prandaj, argumenti i AK-së se dokumentacioni është dërguar para orës 16:00 ose disa minuta para dorëzimit të kërkesës sonë nuk e sanon shkeljen. **Ligji nuk kërkon vetëm dërgimin formal të dokumenteve, por qasje të arsyeshme, të rregullt, pa pengesa, të shpejtë dhe të menjëhershme në dokumentacionin e saktë.**

Si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të AK-së, GOE është privuar nga mundësia reale që ta shqyrtojë në kohë dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar, ta verifikojë ligjshmërinë e ofertës së tij dhe t'i përfshijë në mënyrë të plotë në kërkesën për rishqyrtim të gjitha pretendimet që mund të rezultonin nga ky dokumentacion.

PRETENDIMI NR. 2

Cenimi i ekonomicitetit dhe dëmi potencial ndaj buxhetit publik

Arsyetimi i AK-së në Vendimin e datës 10.08.2026

Lidhur me këtë pretendim, në Vendimin e datës 10.08.2026, **AK nuk ka dhënë një përgjigje të veçantë, konkrete dhe të arsyetuar.**

Kërkesa jonë për rishqyrtim e kishte ngritur këtë çështje si pretendim të veçantë, duke theksuar se oferta e GOE-së sonë ishte në vlerë prej **75,762.71 € pa TVSH**, ndërsa oferta e **AL Engineering SH.P.K.** ishte në vlerë prej **97,881.36 € pa TVSH**.

Diferenca ndërmjet këtyre dy ofertave është **22,118.65 € pa TVSH**, që përfaqëson rreth **22.6% të vlerës së ofertës së AL Engineering SH.P.K.**

Në të njëjtin Procesverbal të Hapjes së Tenderit, vlerat e ofertave me TVSH janë evidentuar në shumën prej **89,400.00 €** për GOE-në tonë dhe **115,500.00 €** për AL Engineering SH.P.K.

Rrjedhimisht, kur merret parasysh vlera me TVSH, diferenca financiare ndërmjet ofertave rritet në **26,100.00 €**, duke mbetur rreth **22.6% e vlerës së ofertës së AL Engineering SH.P.K.**

Kundërpërgjigja e GOE-së

Pikërisht fakti se AK nuk ka dhënë përgjigje konkrete ndaj këtij pretendimi përbën mangësi në arsyetimin e Vendimit.

Ne nuk kemi pretenduar se vetëm fakti që oferta jonë ka çmim më të ulët mjafton që ajo automatikisht të shpallet fituese.

Pretendimi ynë ka qenë se, **nëse arsyet e eliminimit tonë rezultojnë të pabazuara dhe oferta jonë rezulton e përgjegjshme**, atëherë eliminimi i ofertës sonë prej **75,762.71 € pa TVSH / 89,400.00 € me TVSH** dhe rekomandimi i ofertës së AL Engineering SH.P.K. prej **97,881.36 € pa TVSH / 115,500.00 € me TVSH** krijon një pasojë konkrete financiare për buxhetin publik.

Konkretisht, bëhet fjalë për një diferencë prej **22,118.65 € pa TVSH**, respektivisht **26,100.00 € me TVSH**, ose rreth **22.6% të vlerës së ofertës së AL Engineering SH.P.K.**

Në aspektin e shpenzimit real të fondeve publike, diferenca relevante është ajo prej **26,100.00 € me TVSH**, pasi kjo paraqet shumën shtesë që potencialisht do të rëndojë buxhetin publik nëse kontrata realizohet sipas ofertës më të lartë.

AK është dashur ta trajtojë këtë argument dhe të shpjegojë përse, sipas saj, eliminimi i ofertës së GOE-së sonë është i ligjshëm dhe i justifikueshëm, pavarësisht faktit se si rezultat i këtij eliminimi krijohet një diferencë financiare prej **26,100.00 € me TVSH**.

Në mungesë të një arsytimi të tillë, **Pretendimi nr. 2 ka mbetur praktikisht pa përgjigje në Vendimin e datës 10.08.2026.**

PRETENDIMI NR. 3

Arkitekti Driton Kabashi

Arsytimi i AK-së në Vendimin e datës 10.08.2026

AK e konsideron këtë pretendim të pabazuar.

AK i referohet Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurim Publik dhe formulimit sipas të cilit, kur CV-ja nuk e plotëson kërkesën minimale të dosjes së tenderit, oferta refuzohet pa kërkuar sqarim shtesë.

AK deklaron se z. Driton Kabashi ka përfunduar studimet më 28.06.2018 dhe se në CV nuk është paraqitur me saktësi përvoja e punës pas diplomimit.

AK pranon se në CV është shënuar se z. Kabashi ka përvojë pune “**që nga viti 2015 e gjerë më tani**” në NN “Kabashi”, por thekson se CV-ja nuk ka datë të krijimit.

AK ka kontrolluar edhe referencën e NN “Kabashi” si dëshmi shtesë dhe ka konstatuar se ajo është përpiluar në janar 2019 dhe se z. Kabashi paraqitet si pjesë e kompanisë nga 01.02.2017. Sipas AK-së, kjo nuk përputhet me vitin 2015 të deklaruar në CV dhe, për këtë arsye, nuk është dëshmuar përvoja pesëvjeçare pas diplomimit.

Kundërpërgjigja e GOE-së

Nuk pajtohem me këtë konstatim.

AK po e trajton rastin sikur CV-ja të mos përmbante fare periudhë të përvojës profesionale, ndërkohë që në CV është deklaruar shprehimisht angazhimi “**që nga viti 2015 e gjer më tani**”.

Z. Kabashi ka diplomuar më 28.06.2018. Hapja e ofertave është bërë më 13.07.2026. Nga diplomimi deri në ofertim kanë kaluar më shumë se tetë vite. Meqenëse CV-ja deklaron se angazhimi i filluar në vitin 2015 **vazhdon edhe më tej**, kjo periudhë përfshin domosdoshmërisht edhe periudhën pas diplomimit dhe tejkalon pesë vite.

As fakti që CV-ja nuk përmban datën kur është hartuar nuk e rrëzon përmbajtjen e deklaruar në të.

Po ashtu, dallimi ndërmjet vitit 2015 në CV dhe datës 01.02.2017 në referencë nuk e rrëzon përvojën pas diplomimit, sepse **të dyja datat janë para datës së diplomimit, 28.06.2018**. Çështja vendimtare është nëse angazhimi ka vazhduar pas diplomimit, dhe CV-ja deklaron shprehimisht se ka vazhduar **“gjer më tani”**.

Gjithashtu, referencat profesionale nuk kanë qenë të përcaktuara si dëshmi e detyrueshme në DT. Dëshmitë e kërkuara kanë qenë CV-ja, diploma, kontrata e punës ose kontrata mbi vepër dhe lista e stafit.

Prandaj, AK nuk mund ta trajtojë një mospërputhje në dokumentin plotësues si kriter eliminues.

Nëse AK kishte paqartësi për muajin, datën e saktë ose vazhdimësinë e angazhimit, atëherë kemi të bëjmë me sqarimin e një informacioni që ekzistonte në ofertë dhe jo me krijimin e përvojës së re.

Për këto arsye, mbetet i pabazuar konstatimi i AK-së se CV-ja e z. Driton Kabashi nuk dëshmon minimumin pesëvjeçar pas diplomimit.

PRETENDIMI NR. 4

Inxhinieri i Elektrikës Lulzim Halitaj

Arsyetimi i AK-së në Vendimin e datës 10.08.2026

AK e konsideron të pabazuar pretendimin lidhur me z. Lulzim Halitaj.

Sipas AK-së, z. Halitaj ka përfunduar studimet më 04.05.2018, por në CV nuk është paraqitur përvojë pas diplomimit në projekte të ngjashme.

AK deklaron se i ka kontrolluar edhe referencat si dëshmi shtesë dhe ka konstatuar se referenca e EUROING-ut nuk përputhet me CV-në, ndërsa referenca e Sylja Group tregon angazhim në projektim dhe jo në mbikëqyrje të projekteve. Për këtë arsye AK konsideron se nuk është dëshmuar përvoja minimale.

Kundërpërgjigjja e GOE-së

Ky arsyetim nuk përputhet me përmbajtjen e CV-së së dorëzuar.

CV-ja e z. Halitaj paraqet angazhimin në **EUROING nga viti 2018 deri në vitin 2026 dhe vazhdon**. Z. Halitaj ka diplomuar më 04.05.2018, ndërsa hapja e ofertave është bërë më 13.07.2026. Pra periudha pas diplomimit tejkalon tetë vite.

Për më tepër, CV-ja nuk përmban vetëm projektim. Ajo paraqet monitorimin e zbatimit të projekteve elektrike, kontrollin e përputhshmërisë me specifikimet dhe standardet, menaxhimin

dhe mbikëqyrjen e ekipeve dhe burimeve, si dhe monitorim të projekteve në cilësinë e mbikëqyrës.

DT ka kërkuar **projekte të ngjashme**, jo projekte që domosdoshmërisht duhet të kenë titullin identik “Mbikëqyrja e Projekteve”.

Prandaj, fakti që një referencë e Sylja Group përdor termin “projektim” nuk është i mjaftueshëm për të përjashtuar tërë përvojën tjetër të evidentuar në CV.

Në dokumentacion është dorëzuar edhe Lista e Projekteve të Menaxhuara 2018–2025, e cila përfshin projektim, menaxhim, auditim energjetik, monitorim dhe realizim projektesh elektrike e ndërtimore.

Edhe në këtë rast referencat nuk kanë qenë dëshmi të detyrueshme sipas DT-së. Prandaj, një gabim apo mospërputhje eventuale në një referencë plotësuese nuk mund të përdoret për të zhvlerësuar CV-në dhe dokumentet që AK vetë i ka përcaktuar si dëshmi të obligueshme.

Rrjedhimisht, konstatimi se z. Halitaj nuk e dëshmon përvojën pesëvjeçare nuk qëndron përballë përmbajtjes konkrete të CV-së.

PRETENDIMI NR. 5

Inxhinieri i Gjeodezisë Luan Abazi

Arsyetimi i AK-së në Vendimin e datës 10.08.2026

AK e konsideron të pabazuar pretendimin lidhur me z. Luan Abazi.

AK deklaron se z. Abazi ka përfunduar studimet Master në Gjeodezi më 18.02.2014 dhe se në CV nuk është paraqitur përvoja e punës pas diplomimit.

AK deklaron gjithashtu se ka kontrolluar referencat si dëshmi shtesë dhe se prej tyre nuk rezulton përvojë pesëvjeçare pas diplomimit, sipas kërkesës së DT-së.

Kundërpërgjigja e GOE-së

Ky konstatim bie ndesh drejtpërdrejt me përmbajtjen e CV-së.

Së pari, në kërkesën specifike të DT-së për pozitën ë) është kërkuar Bachelor i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës, drejtimi Gjeodezi, i licencuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Në këtë kërkesë specifike nuk është përcaktuar shprehimisht minimumi prej pesë viteve pas diplomimit.

Së dyti, edhe nëse sqarimi i përgjithshëm për pesë vite konsiderohet i zbatueshëm edhe për këtë pozitë, z. Abazi e plotëson atë dukshëm.

Në CV është deklaruar:

“Janar 2013 – vazhdon”

në cilësinë e ekspertit të gjeodezisë, drejtorit dhe gjeodetit të licencuar.

CV-ja përmban matje gjeodezike, piketim, **mbikëqyrje profesionale**, matje me GPS dhe TCR, hartim dhe revidim projektesh, projekte rrugore e infrastrukturore, si dhe projektin konkret **“Mbikëqyrja e projekteve investive Lot 1/Pjesa 1”**.

Z. Abazi ka diplomuar më 18.02.2014, ndërsa hapja është bërë më 13.07.2026. Nga diplomimi deri në hapjen e ofertave kanë kaluar mbi 12 vite.

Prandaj, nuk qëndron deklarimi i AK-së se në CV **“nuk është prezantuar përvoja e punës pas diplomimit”**, kur vetë CV-ja deklaron angazhim nga janari 2013 dhe në vazhdim.

Referencat nuk kanë qenë dëshmi të detyrueshme. Edhe nëse merren në konsideratë, ato paraqesin projekte në gjeodezi, infrastrukturë, rrugë, kanalizim, ujësjellës, matje, piketim dhe mbikëqyrje profesionale.

Për këto arsye, pretendimi ynë lidhur me z. Luan Abazi mbetet i bazuar.

PRETENDIMI NR. 6

Inxhinieri i Gjeodezisë Agron Shabani

Arsyetimi i AK-së në Vendimin e datës 10.08.2026

AK e konsideron të pabazuar pretendimin lidhur me z. Agron Shabani.

AK deklaron se z. Shabani ka përfunduar studimet më 27.07.2011, por se në CV nuk është paraqitur përvoja e punës pas diplomimit që i përgjigjet projekteve të ngjashme.

AK deklaron se ka kontrolluar edhe referencat si dëshmi shtesë dhe se nga ato nuk rezulton përvoja pesëvjeçare pas diplomimit sipas kërkesës së DT-së.

Kundërpërgjigjja e GOE-së

Edhe ky konstatim është në kundërshtim me dokumentet e dorëzuara.

Së pari, në pikën specifike ë1) AK ka kërkuar **“Një Bachelor të Gjeodezisë”**. Në këtë kërkesë specifike nuk është përcaktuar shprehimisht minimumi prej pesë viteve përvojë pas diplomimit.

Së dyti, edhe nëse zbatohet sqarimi i përgjithshëm për pesë vite, CV-ja e z. Shabani e plotëson dukshëm kërkesën.

Në CV është deklaruar angazhimi:

“Nga viti 2013 e tutje në N.SH. GEO-MAP, në pozitën Drejtues Teknik.”

CV-ja paraqet udhëheqje të matjeve gjeodezike, menaxhim projektesh, incizime gjeodezike dhe projekte rrugore e infrastrukturore. Z. Shabani ka diplomuar më 27.07.2011 dhe nga diplomimi deri në hapjen e ofertave kanë kaluar gati 15 vite.

Për më tepër, edhe referencat që AK thotë se i ka kontrolluar si dëshmi shtesë nuk e mbështesin konkluzionin e saj.

Referenca e N.SH. “GEO-MAP” konfirmon se z. Shabani është i angazhuar nga **01.09.2013 e deri më sot** si:

“Udhëheqës – Mbikëqyrës i punëve gjeodezike dhe kadastrale.”

Po ashtu, referenca e Pro&Co Group përmban përcjellje të punëve gjeodezike, udhëheqje dhe **mbikëqyrje të punishtes** në projekte të ujësjellësit, kanalizimit, trotuareve, rrugëve dhe urave.

Prandaj, konstatimi i AK-së se as CV-ja dhe as referencat nuk tregojnë përvojë në projekte të ngjashme nuk përputhet me përmbajtjen e dokumenteve.

PRETENDIMI NR. 7

Pajisja nr. 1 – Instrumenti GPS për matje gjeodezike

Arsyetimi i AK-së në Vendimin e datës 10.08.2026

AK e konsideron pretendimin të pabazuar me arsyetimin:

“mungon dëshmia që pajisja me nr. 1 në listën e pajisjeve është në gjendje të rregullt teknike dhe është e kalibruar.”

Kundërpërgjigja e GOE-së

Nuk kontestohet se në përshkrimin teknik AK ka kërkuar që Instrumenti GPS të jetë i kalibruar dhe në gjendje të rregullt teknike.

Mirëpo, çështja është **çfarë dëshmie ka kërkuar AK në DT për plotësimin e këtij kriteri.**

Në pjesën “Dëshmia e kërkuar”, AK ka kërkuar dokumentet e pronësisë ose, kur pajisja merret në shfrytëzim, marrëveshjen për shfrytëzim. AK nuk ka përcaktuar si dëshmi të detyrueshme certifikatë kalibrimi, raport servisi, raport teknik apo dokument tjetër të posaçëm.

GOE ka dorëzuar marrëveshjen për shfrytëzim ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe GeoMetri SH.P.K., të nënshkruar dhe vulosur, në të cilën pajisja është identifikuar pikërisht si:

“Instrumenti GPS për matje gjeodezike (instrumenti duhet të jetë i Kalibruar dhe në gjendje të rregullt teknike)”.

Prandaj, AK në Vendim përsëri deklaroi vetëm se “mungon dëshmia”, por nuk tregon se **ku në DT është kërkuar certifikata apo dokumenti i veçantë** që, sipas AK-së, ne është dashur ta dorëzojmë.

Nëse AK kishte nevojë për verifikim shtesë të kalibrimit të pajisjes ekzistuese, kjo duhej të trajtohej si çështje sqarimi dhe jo të shndërrohej pas hapjes së ofertave në një formë të re të detyrueshme të dëshmimit.

PRETENDIMI NR. 8

Pajisja nr. 2 – Instrumenti për matjen e temperaturës së asfaltit sipas standardit EN 13108

Arsyetimi i AK-së në Vendimin e datës 10.08.2026

AK e konsideron pretendimin të pabazuar sepse:

“mungon dëshmia që pajisja me nr. 2 në listën e pajisjeve punon sipas standardit EN 13108.”

Kundërpërgjigjja e GOE-së

Në DT është kërkuar instrumenti për matjen e temperaturës së asfaltit i cili punon sipas EN 13108.

Mirëpo, në pjesën “Dëshmia e kërkuar”, AK nuk ka kërkuar certifikatë konformiteti, certifikatë kalibrimi, raport testimi apo deklaratë të prodhuesit.

Dëshmia e kërkuar ka qenë dokumentacioni për pronësinë ose të drejtën e shfrytëzimit të pajisjes.

GOE ka dorëzuar marrëveshjen ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe RICENS SH.P.K., ku pajisja është identifikuar shprehimisht si instrument për matjen e temperaturës së asfaltit **që punon sipas standardit EN 13108.**

AK përsëri nuk ka treguar në Vendim se cili dokument specifik është kërkuar në DT dhe nuk është dorëzuar nga GOE.

Nuk mund të kërkohej pas hapjes së ofertave një certifikatë apo formë tjetër e posaçme e dëshmimit, nëse ajo nuk ishte përcaktuar paraprakisht si dëshmi e obligueshme.

PRETENDIMI NR. 9

Pajisja nr. 4 – Kon metalik për testimin e betonit sipas standardit EN 12350-2

Arsyetimi i AK-së në Vendimin e datës 10.08.2026

AK e konsideron pretendimin të pabazuar sepse:

“mungon dëshmia që pajisja me nr. 4 në listën e pajisjeve punon sipas standardit EN 12350-2.”

Kundërpërgjigjja e GOE-së

Edhe për këtë pajisje arsyetimi i AK-së nuk adreson argumentin tonë kryesor.

Në DT është përcaktuar karakteristika teknike EN 12350-2, por në pjesën “Dëshmia e kërkuar” nuk është kërkuar certifikatë konformiteti, raport testimi apo deklaratë e prodhuesit.

Është kërkuar dëshmia e pronësisë ose marrëveshja për shfrytëzim.

GOE ka dorëzuar marrëveshjen për qeranë e pajisjeve ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe RICENS SH.P.K., në të cilën pajisja nr. 4 është identifikuar me të njëjtin përshkrim dhe shprehimisht me standardin **EN 12350-2**.

Prandaj, vetëm formulimi i përsëritur “mungon dëshmia” nuk mjafton. AK është dashur të tregojë se cili dokument i përcaktuar në DT ka munguar.

Nëse ka ekzistuar paqartësi për përputhshmërinë teknike, ajo mund të verifikohet pa ndryshuar pajisjen e ofruar apo përmbajtjen materiale të ofertës.

PRETENDIMI NR. 10

Pajisja nr. 5 – Pllaka për testimin e aftësisë mbajtëse sipas standardit EN 13792

Arsyetimi i AK-së në Vendimin e datës 10.08.2026

AK e konsideron pretendimin të pabazuar sepse:

“mungon dëshmia që pajisja me nr. 5 në listën e pajisjeve punon sipas standardit EN 13792.”

Kundërpërgjigjja e GOE-së

Në DT është kërkuar pajisja sipas standardit EN 13792, ndërsa si dëshmi është kërkuar dokumentacioni për pronësinë ose marrëveshja për shfrytëzim.

Nuk është përcaktuar si dëshmi e obligueshme certifikatë konformiteti, raport testimi apo deklaratë e prodhuesit.

GOE ka dorëzuar marrëveshjen ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe RICENS SH.P.K., në të cilën pajisja nr. 5 është identifikuar me të njëjtin përshkrim dhe me standardin **EN 13792**.

Prandaj, AK nuk ka treguar se cili dokument konkret i kërkuar nga DT mungon në ofertën tonë.

Nëse AK ka konsideruar se përmbajtja e marrëveshjes nuk ishte e mjaftueshme për verifikimin teknik, atëherë duhej të sqarohej ajo paqartësi dhe jo të vendosej gjatë vlerësimit një lloj i ri dokumenti që nuk ishte përcaktuar në DT.

PRETENDIMI NR. 11

Pajisja nr. 7 – Instrumenti për matjen e trashësisë së shtresës së ngjyrës sipas ISO 2808, EN ISO 2808 dhe ASTM D 4414

Arsyetimi i AK-së në Vendimin e datës 10.08.2026

AK e konsideron këtë pretendim të pabazuar sepse:

“mungon dëshmia që pajisja me nr. 7 në listën e pajisjeve punon sipas standardit ISO 2808, EN ISO 2808 ASTM D 4414.”

Kundërpërgjigjja e GOE-së

Edhe ky arsyetim është vetëm përsëritje e arsyes fillestare të eliminimit dhe nuk i përgjigjet argumentit tonë.

Në DT janë përcaktuar standardet ISO 2808, EN ISO 2808 dhe ASTM D 4414. Megjithatë, si dëshmi e kërkuar nuk është përcaktuar certifikatë konformiteti, raport testimi, deklaratë e prodhuesit apo dokument tjetër i posaçëm teknik.

Është kërkuar dokumentacioni që dëshmon pronësinë ose të drejtën e shfrytëzimit të pajisjes.

GOE ka dorëzuar marrëveshjen ndërmjet P.M.N. SH.P.K. dhe I.T.K. SH.P.K., në të cilën pajisja nr. 7 është identifikuar shprehimisht si:

“Instrument për matje të trashësisë së ngjyrës sipas standardit ISO 2808, EN ISO 2808, ASTM D 4414.”

Prandaj, AK nuk ka identifikuar në Vendimin e saj asnjë dispozitë konkrete të DT-së ku është kërkuar dokumenti shtesë teknik për mungesën e të cilit oferta është eliminuar.

Nëse AK kishte dyshim lidhur me përputhshmërinë e pajisjes ekzistuese me standardet e deklaruara, kjo mund të verifikohej përmes sqarimit, pa ndryshuar pajisjen e ofruar dhe pa ndryshuar përmbajtjen materiale të ofertës.

PËRFUNDIM

Nga trajtimi i mësipërm rezulton se për secilin pretendim të ngritur në kërkesën për rishqyrtim, arsyetimi i Vendimit të AK-së të datës 10.08.2026 ose nuk i përgjigjet përmbajtjes konkrete të dokumenteve të ofertës, ose përsërit arsyet fillestare të eliminimit pa adresuar kundërshtimet konkrete të GOE-së.

Në veçanti:

- për pretendimin nr. 1, vetë AK pranon gabimin gjatë qasjes, ndërsa dokumentacioni është dërguar vetëm në ditën e fundit dhe në mënyrë të fragmentuar;
- pretendimi nr. 2 nuk është trajtuar me arsyetim të veçantë;
- për pretendimet nr. 3, 4, 5 dhe 6, përmbajtja konkrete e CV-ve dhe periudhat e deklaruara nuk përputhen me konstatimin e AK-së se nuk dëshmohet përvoja profesionale;
- për pretendimet nr. 7, 8, 9, 10 dhe 11, AK nuk ka identifikuar dokumentin konkret të paraparë në DT që pretendohet se mungon, por ka kërkuar në fazën e vlerësimit dëshmi teknike të cilat nuk janë përcaktuar shprehimisht në pjesën “Dëshmia e kërkuar”.

Për këto arsye, GOE mbetet pranë pretendimeve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim dhe kundërshton arsyetimin dhe përfundimet e Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës **05.08.2026**.

VENDIM

APROVOHET si e bazuar Ankesa e “P.M.N.”SH.P.K&NPN "UNIVERS-MI lidhur me tenderin **Mbikëqyrja e Projekteve** me nrp: **632-26-4696-2-1-1**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e **Mbikëqyrja e Projekteve** dhe lënda të kthehet në **RI-VLERËSIM**.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara-humbura, shpenzime përgatitore në aspektin teknik për kontratë NE VLERE PREJ 4500EURO. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani serioze, dhe me një përvojë të madhe në fushën e ndërtimeve.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Ne i kemi bashkangjitur Ankesës tonë dokumentet e renditura më poshtë:

- Një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë”
- Një kopje të publikimit për “Njoftimi mbi Vendimin e AK”
-

Vërejtje: Të gjitha pretendimet tona mbështeten me fakte që i gjeni të bashkangjitura kësaj ankese por edhe në dokumentacionin e AK

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

